

## Gjykata e Apelit

Numri i lëndës: 648/16

Data: 22 qershor 2017

Gjykata Themelore e Mitrovicës: P. nr. 122/2014

Gjykata e Apelit, në Kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant në cilësinë e Kryetares së Kolegjit, Gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki në cilësinë e gjyqtarit raportues dhe Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit të Kosovës Hava Haliti në cilësinë e anëtares së Kolegjit, të ndihmuar nga Bekim Ahmeti, këshilltar ligjor i EULEX-it në cilësinë e procesmbajtësit,

në lëndën penale kundër të Akuzuarit:

**Xh K**, emri i babait R, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës S B, i lindur më ..., në fshatin L, Komuna e P, në paraburgim nga data 6 tetor 2015;

i akuzuar me Aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të datës 9 nëntor 2015 PPS numër 08/09 të:

### **Akuza I**

Krime lufte kundër popullsisë civile që parashihet dhe dënohet nga nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e penalizuar sipas neneve 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në shkelje të nenit të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit Shtesë II që përmban veprimet penale si më poshtë:

#### **Pika 1:**

##### **Vrasje si krim i luftës kundër popullatës civile:**

në veçanti, se i Akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së duke mbajtur post me gradë të lartë në Qendrën e UÇK-së në K (Sh), në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, ka vrrarë A B derisa është mbajtur në mënyrë të paligjshme në Kampin e K duke e rrahur dhe shtënë në të, në Kukës (v të Sh) më 4 ose 5 qershor 1999;

#### **Pika 2:**

##### **Mbajtje ilegale si krim i luftës kundër popullatës civile:**

në veçanti, se i Akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S G dhe pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, ka arrestuar dhe ndaluar në mënyrë të paligjshme Dëshmitarët A, B, C, D, E, F, H, K A B dhe civilë të tjerë të panjohur në një qendër të tillë për një kohë të gjatë, në K (v të Sh), gjatë muajve prill, maj dhe përgjatë mesit të qershorit të vitit 1999.

**Pika 3:**

**Kushte çnjerëzore si krim lufte kundër popullatës civile:**

në veçanti, se i Akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S G dhe pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, ka mbajtur Dëshmitarët A, B, C, D, E, F, H, **A B** dhe civilë të tjerë të panjohur në një qendër të tillë nën kushte çnjerëzore (qeli të vogla, me mungesë të ujit, të ushqimit, të pastërtisë, të ajrit dhe të qasjes në trajtime mjekësore), në K (v të Sh), gjatë muajve prill, maj dhe përgjatë mesit të qershorit të vitit 1999;

**Pika 4:**

**Torturë si krim lufte kundër popullatës civile:**

në veçanti, se i Akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S G dhe pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, ka torturuar Dëshmitarët A, B, C, H, dhe A B duke i rrahur ata deri në humbjen e vetëdijes me shufra e shkopinj në Kukës (veri të Sh), në një datë të panjohur në maj të vitit 1999;

**Pika 5:**

**Shkelje të integritetit trupor apo të shëndetit si krim lufte kundër popullatës civile:**

në veçanti, se i Akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S G dhe pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e dëshmitarëve, A, B, C, D, E, F, H dhe **A B** duke i rrahur ata vazhdimisht apo duke i urdhëruar të tjerët që ta bëjnë atë në K (v të Sh), gjatë muajve prill, maj dhe përgjatë mesit të qershorit të vitit 1999.

#### **Pika 6:**

##### **Mbajtje ilegale si krim lufte kundër popullatës civile**

në veçanti, se i Akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së

- ka mbajtur Dëshmitarët K, L, M dhe N në kampin e C (Sh e v) gjatë muajve prill, maj dhe përgjatë mesit të qershorit të vitit 1999, dhe
- në mënyrë të paligjshme ka mbajtur Dëshmitarët L dhe N në një garazh në Prizren në ditë të panjohura në muajin qershor të vitit 1999;

#### **Pika 7:**

##### **Shkelje të integritetit trupor apo të shëndetit si krime lufte kundër popullatës civile:**

se i Akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një individi të panjohur nga P, në C (Sh e v) në një datë të panjohur në maj apo qershor të vitit 1999; dhe:

#### **Akuza II**

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve të zjarrit, të paraparë dhe të dënueshme me nenin 374, paragrafi 1, në lidhje me nenin 120, pikën 38, të KPRK-së e përbërë nga veprimi penal si më poshtë:

se në datën e arrestimit të tij (06 tetor 2015) në veturën e tij janë gjetur, një pistoletë 7.62 mm M56, dhe tri thika;

i Akuzuari është liruar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 184/15 të datës 8 gusht 2016 (më tej në tekst: aktgjykimi i ankimuar) nga Akuza I pika 1 e Aktakuzës, përkatësisht nga Vrasja si Krim i Luftës kundër popullatës civile; dhe

i akuzuari është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas të njëjtit Aktgjykim për veprat penale vijuese të përshkruara në aktakuzë:

- **Mbajtje ilegale si krim i luftës** kundër popullatës civile e përshkruar dhe cilësuar në Akuzën I Pikën 2, me 5 vite burgim;

- **Kushte çnjerëzore si krim lufte** kundër popullatës civile e përshkruar dhe cilësuar në Akuzën I Pikën 3, me 6 vite burgim;
- **Torturë si krim lufte kundër popullatës civile** e përshkruar dhe cilësuar në Akuzën I Pikën 4 me 7 vite burgim;
- **Shkelje të integritetit trupor apo të shëndetit si krim lufte kundër popullatës civile** e përshkruar dhe cilësuar në Akuzën I Pikën 5, me 6 vite burgim;
- **Mbajtje ilegale si krim lufte kundër popullatës civile** e përshkruar dhe cilësuar në Akuzën I Pikën 6, me 6 vite burgim;
- **Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve të zjarrit** e përshkruar dhe cilësuar në Akuzën II me gjobë prej 1.500 euro (njëmijë e pesëqind)

derisa pika që përshkruhet dhe cilësohet në Akuzën I Pika 7 e aktakuzës është refuzuar duke u mbështetur në nenin 363 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 i KPP-së sepse Prokurori është tërhequr nga ajo;

i Akuzuari është dënuar sipas nenit 80 të KPRK-së me dënim unik prej 8 (tetë) vitesh me burg dhe një gjobë prej 1.500 euro (njëmijë e pesëqind) i cili i ka përfshirë të gjitha dënimet individuale të cekura më lartë;

derisa me të njëjtin Aktgjykim janë konfiskuar dhe është urdhëruar shkatërrimi i sendeve si në vijim sipas nenit 115 paragrafi 5 i KPK-së: 1 pistoletë M57 me kalibër 7.62 me numër serik 19Z45Z, karikator i plotë me gjithsej 19 fishekë, një këllëf i pistoletës, 1 thikë paluese me ngjyrë të zezë, një thikë paluese me ngjyrë të gjelbër dhe një thikë shumë pjesësh e kuqe, dhe

sipas nenit 83 paragrafi 1 i KPRK-së koha e kaluar nga Xh Knë paraburgim si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë në lidhje me veprat penale që nga 06 tetori i vitit 2015 e deri më 8 gusht 2016 llogariten si vuajtje e dënimit me burg;

pas ankesave të parashtruara nga:

- Avokati mbrojtës i Xh K, H M më 9 nëntor 2016;
- Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK) më 07 nëntor 2016;

pas shqyrtimit të propozimit të Prokurorit Shtetëror të Apelit të Kosovës të parashtruar më 27 dhjetor 2016;

pas këshillimit të mbajtur më 17 maj dhe 22 qershor 2017, dhe votimit më 22 qershor 2017,

nxjerr këtë:

#### AKTGJYKIM

- I. Duke u mbështetur në nenin 385 paragrafi 1 nën-par. 1.4 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)<sup>1</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës në lëndën numër P.nr.184/15, i datës 8 gusht 2016 (më tej në tekst: aktgjykimi i ankimuar) ndryshohet në pjesët si në vijim:
  - 1.1. në lidhje me Pikën 3 të Akuzës I (**Kushte çnjerëzore**) e cila ri-cilësohet si kryerje e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti trajtim mizor, poshtërues dhe nënçmues të personave të cekur në këtë pikë, dhe prandaj cilësohet si krim lufte ndaj personave sipas nenit 31 dhe nenit 152 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 të KPRK-së dhe në shkelje të nenit 4 paragrafi 2 (a) të Protokollit Shtesë II (PSH II) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe për këtë vepër penale sipas nenit 31 dhe nenit 152 paragrafi 1 të KPRK-së të ndryshuar me nenin 33 paragrafi 2 i Kushtetutës dhe nenit 38 paragrafi 1 i Kodit Penal të RSFJ-së sipas formulimit të tij siç ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977 i cili është mbajtur në fuqi nga paragrafi 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, ai dënohet me 5 (pesë) vite burgim;
  - 1.2. në lidhje me Pikën 4 të Akuzës I (**Tortura**) e cila cilësohet si dhunë ndaj jetës dhe personave të cekur në këtë pikë, dhe prandaj kjo cilësohet si krim i luftës ndaj personave sipas nenit 31 dhe nenit 152 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 i KPRK-së, dhe në shkelje të nenit 4 paragrafi 2 (a) i Protokollit Shtesë II i Konventave të lartpërmendura, dhe për këtë vepër penale sipas nenit 31 dhe nenit 152 paragrafi 1 të KPRK-së dhe nenit 45 paragrafi 1 të KPRK-së të ndryshuar me nenin 33 paragrafi 2 i Kushtetutës dhe nenit 38 paragrafi 1 i Kodit Penal të RSFJ-së sipas formulimit të tij siç ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977 i cili është mbajtur në fuqi nga paragrafi 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, ai dënohet me 6 (gjashtë) vite burgim;

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 04/L-082

- 1.3. në lidhje me Pikën 5 të Akuzës I (**Shkelje e integritetit trupor dhe të shëndetit**) e cila ri-cilësohet si fyerje ndaj dinjitetit të personit, në veçanti trajtim mizor, poshtërues dhe nënçmues të personave të cekur në këtë pikë, dhe prandaj cilësohet si krim lufte ndaj personave sipas nenit 31 dhe nenit 152 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 të KPRK-së dhe në shkelje të nenit 4 paragrafi 2 (a) të Protokollit Shtesë II (PSH II) të Konventave të lartpërmendura, dhe për këtë vepër penale sipas nenit 31 dhe nenit 152 paragrafi 1 të KPRK-së dhe nenit 45 paragrafi 1 të KPRK-së të ndryshuar me nenin 33 paragrafi 2 i Kushtetutës dhe nenit 38 paragrafi 1 i Kodit Penal të RSFJ-së sipas formulimit të tij siç ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977 i cili është mbajtur në fuqi nga paragrafi 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, ai dënohet me 6 (gjashtë) vite burgim;
- 1.4. në lidhje me Akuzën II (Posedim i paligjshëm i armës) Xh K shpallet fajtor për veprën penale në vijim:
- se më 6 tetor 2015 duke qenë pa Leje për Bartje të Armës e cila kërkohet sipas nenit 18 të Ligjit nr. 05/L -022 mbi Armët ai ka qenë në posedim të pistoletës M57 kal. 7.62 mm me numër serik 19Z45Z, dhe të karikatorit të plotë me gjithsej 19 fishekë që përbën armë të kategorisë B1 siç përkufizohen nga Ligji i lartpërmendur dhe prandaj ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve të zjarrit sipas nenit 374 paragrafi 1 të KPRK-së dhe sipas nenit 374 paragrafi 1 të KPRK-së ai dënohet me gjobë prej 1200 euro (njëmijë e dyqind);
- 1.5. duke u mbështetur në nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-së, pistoleta M57 kal. 7.62 mm me numër serik 19Z45Z, dhe karikatorit i plotë me gjithsej 19 fishekë konfiskohen dhe sipas nenit 115 paragrafi 5 i KPP-së duhet të shkatërrohen;
- 1.6. duke u mbështetur në nenin 115 paragrafi 1 të KPPRK-së, sendet e mëposhtme të cilat janë sekuestruar përkohësisht me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 12 tetor 2015: 1 thikë paluese me ngjyrë të zezë, 1 thikë paluese me ngjyrë të gjelbër, 1 këllëf i pistoletës, dhe 1 thikë shumë pjesësh e kuqe duhet t'i kthehen Xh K;

- 1.7. veprimet që përshkruhen në Akuzën I Pikat 2 dhe 6 (**Mbajtja e paligjshme**) se janë kryer nga Xh K cilësohen si Shtrëngim siç përkufizohet në nenin 46 paragrafi 1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSA) të datës 28 qershor 1977<sup>2</sup>, dhe sipas nenit 363 paragrafi 1.3 të KPP-së, këto akuza refuzohen për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit në nenin 95 paragrafi 1 nën-paragrafi 6 të KPRSFJ-së;
  - 1.8. dënimi unik i shqiptuar ndaj Xh K ndryshohet dhe sipas nenit 48 paragrafët 3 dhe 6 të KPRSFJ-së ai dënohet me dënim unik me burg prej 7 (shtatë) vitesh dhe 1200 euro (njëmijë e dyqind);
  - 1.9. duke u mbështetur në nenin 50 paragrafët 1 dhe 3 të KPRSFJ-së, së koha e kaluar nga Xh K në paraburgim përkatësisht nga 06 tetori i vitit 2015 e deri më 22 qershor 2017 llogariten si vuajtje e dënimit me burg;
  - 1.10. duke u mbështetur në nenin 453 paragrafi 1 dhe nenin 456 paragrafi 1 i KPRK-së (të ri), i pandehuri duhet të kompensojë shpenzimet e procedurës penale, në shumën prej 2.200 (dy mijë e dyqind euro);
- II. Në pjesën e mbetur, përkatësisht në lidhje me Akuzën I Pika 1 e Aktakuzës, Aktgjykimi i ankimuar vërtetohet.

---

<sup>2</sup> PS Nr. 011-25/77

## Arsyetim

### I. Historiku procedural

1. Më 8 gusht 2016, Gjykata Themelore e Mitrovicës e ka nxjerrë aktgjykimin në lëndën penale P.nr. 184/15 ndaj Xh K. Hollësitë e këtij aktgjykimi janë paraqitur më sipër në dispozitivin e këtij aktgjykimi.
2. Prokuroria dhe avokati mbrojtës i kanë parashtruar ankesat kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Të dy ankesat janë parashtruar brenda periudhës së përcaktuar kohore.
3. Ankesa e PSRK-së:

3.1 PSRK-ja e ka kundërshtuar aktgjykimin e ankimuar mbi bazat si në vijim:

- a) shkelje e ligjit penal në lidhje me vrasjen e A B. Prokurori ka parashtruar se faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë tregojnë se i akuzuari ka marrë pjesë në një Ndërmarrje të Përbashkët Kriminale (NPK) dhe se ka kontribuar në vrasjen e A B duke vepruar me dashje eventuale, gjegjësisht se ka mundur me lehtësi të parashikojë pasojat e veprimeve të pjesëmarrësve të tjerë të NPK-së të cilat kanë çuar në vdekjen e viktimës;
- b) përcaktimi joadekuat i sanksioneve penale për veprat penale të veçanta që i atribuohen të akuzuarit meqë dënimi ka qenë tepër joproportional me peshën e veprave penale. Prokurori ka vënë në dukje se Gjykata Themelore ka dështuar në analizimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për përcaktimin e dënimit. Prokurori ka parashtruar se Gjykata e ka shkelur parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm duke i përzier dispozitat që rrjedhin nga ligje të ndryshme, përkatësisht duke zbatuar Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë njëkohësisht me nenin 80 të Kodit Penal të Kosovës.

3.2 Prokurori ka kërkuar që të rritet dënimi për të pandehurin.

### 4. Ankesa e avokatit mbrojtës

4.1 Mbrojtja ka parashtruar se provat janë mbledhur duke shkelur rëndë rregullat procedurale. Sipas tij, këto shkelje kanë kontribuar në vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Në veçanti, avokati i është referuar:

- a) Identifikimit të paligjshëm të të akuzuarit



Mbrojtja ka vënë në dukje që mënyra sipas të cilës është bërë identifikimi i të akuzuarit e ka shkelur dispozitën procedurale relevante jo vetëm në fazën e hetimeve por edhe gjatë seancave gjyqësore.

b) Udhëzimi i dëshmitarëve.

Avokati ka parashtruar se Prokurori i ka testuar apo i ka udhëzuar dëshmitarët duke u takuar me ta para dhënies së dëshmisë në gjykim pa e njoftuar gjykatën. këto veprime e kanë shkelur parimin e barazisë së armëve meqë ai mund të ketë ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve.

c) Mospërfillja e provave në favor të të akuzuarit.

Avokati mbrojtës ka parashtruar se nuk u është dhënë vëmendje e duhur dëshmive të dëshmitarëve A P, B P, A H, N B.

d) Mospërfillja e provave ndaj besueshmërisë së Dëshmitarit G.

Gjykata e ka injoruar provën që tregon se dëshmitari është diagnostikuar me sëmundje mendore.

e) Shkelja e rregullave që zbatohen për Mbështetjen e Pohimit në lidhje me dëshminë e dëshmitarit O K)

f) Përdorimi i provave të papranueshme të Dëshmitarit K.

g) Përdorimi i provave të mbledhura në gjykimin kundër S G.

4.2 Mbrojtja ka parashtruar që shkeljet e mësipërme të rregullave procedurale kanë rezultuar në gabime që lidhen me faktet e vërtetuara nga gjykata themelore si më poshtë:

a) Konstatimi i gabuar se i akuzuari ka pasur post të lartë në UÇK edhe pse kjo është mohuar nga dëshmitarët N B, R S dhe A I.

b) Konstatimi i gabuar se objektet në Kukës kanë qenë në fakt qendër e mbajtjes e UÇK-së.

4.3 Për më tepër, Avokati Mbrojtës ka vënë në dukje se veprimet konkrete dhe individuale të të akuzuarit nuk janë vërtetuar prandaj ai nuk mund të japë përgjegjësi për veprimet e të tjerëve.

4.4 Për më tepër, avokati mbrojtës e ka kundërshtuar vendimin mbi dënimet. Sipas tij, Gjykata nuk i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese në favor të të Pandehurit – se prindërit

e tij janë të sëmurë dhe mbi 80 vjeçar, që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale.

## II. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

### 1. Në lidhje me saktësinë e vërtetimit të fakteve

- 1.1 Gjykata e Apelit pajtohet plotësisht me konstatimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me rrethanat e vdekjes së A B. Provat e paraqitura në gjykim nuk kanë treguar ndonjë rrethanë tjetër relevante përveç atyre të vërtetuara dhe të paraqitura nga trupi gjykues. Gjykata e Apelit vëren *ex officio* se S G është liruar përfundimisht nga akuza për vrasjen e A B. Gjykata e Apelit pajtohet me analizën e paraqitur në aktgjykimin e ankimuar sa i përket hipotezës së Prokurorit se vrasja është si rezultat i një Ndërmarrjeje të Përbashkët Kriminale me pjesëmarrjen e Xh K duke vepruar me dashje eventuale (*dolus eventualis*). Argumentimi i hollësishëm dhe i zgjeruar i kësaj çështjeje i paraqitur nga gjykata e shkallës së parë është plotësisht bindës.
- 1.2 Pas një analize të hollësishme të të gjitha kundërshtimeve lidhur me saktësinë e vërtetimit të fakteve të cilat janë ngritur nga avokati mbrojtës, Gjykata e Apelit konkludon se gjetjet e gjykatës së shkallës së parë korrespondojnë plotësisht me provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor.
- 1.3 Vlerësimi i secilës provë të paraqitur nga gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar është në përputhje të plotë me fushëveprimin e diskrecionit të cilin e ka trupi gjykues. Nuk ka elemente që do t'i kundërviheshin logjikës elementare apo mendjes së shëndoshë. Arsyetimi përmban një shpjegim të detajuar të vlerës provuese të provave të cilat janë përdorur si bazë për vërtetimin e fakteve.
- 1.4 Trupi gjykues i ka shoshitur me përpikëri të gjitha informatat të cilat rrjedhin nga provat. Prandaj, supozimi i paraqitur nga avokati mbrojtës se disa dëshmi kanë qenë në kundërshtim me gjetjet e fakteve nuk lejon që këto gjetje të konsiderohen si të gabuara. Në veçanti, avokati mbrojtës ka vënë në dukje se nuk u është dhënë konsideratë e duhur dëshmive të dëshmitarëve A P, B P, A H, N B. Gjykata e Apelit konkludon se vlerësimi i vlerës provuese të këtyre dëshmive bie në fushëveprimin e diskrecionit juridik i cili është e drejtë e trupit gjykues. Referimi i avokatit mbrojtës në gjetjet që kanë të bëjnë me postin e mbajtur nga i akuzuari në UÇK nuk korrespondojnë me

përmbajtjen e arsytimit të aktgjykimit meqë trupi gjykues ka treguar se nuk është provuar që ky post ka qenë post i lartë.

- 1.5 Lidhur me parregullsitë gjatë identifikimit të të Akuzuarit të cilat janë vënë në pah nga Mbrojtja, Gjykata e Apelit është e mendimit që identifikimi i të Akuzuarit në gjykim nuk ngrit dyshime lidhur me besueshmërinë e tij. Prandaj, këto parregullsi nuk kanë rezultuar me vërtetimin e gabuar të fakteve.
- 1.5.1 Dëshmitari i cili e ka njohur të Akuzuarin e ka pasur mundësinë që për një kohë të gjatë ta shikojë atë në kohën kritike dhe dëshmitë e tij përkitazi me njohjen e fajtorit e vërtetojnë njëra-tjetrën.
- 1.6 Në lidhje me pretendimet përkitazi me takimet e Prokurorit me dëshmitarët pas ngritjes së aktakuzës, Gjykata e Apelit vëren se në praktikën gjyqësore është diskutuar gjerësisht nëse kjo praktikë mund të ketë efekt paragjykues në vlerën provuese të dëshmisë së dëshmitarit.
- 1.6.1 Kësaj praktike shpesh i referohet si “testim të dëshmitarit” apo “njoftim të dëshmitarit”. Një shprehje tjetër e cila paraqitet në praktikën gjyqësore është “udhëzim i dëshmitarit” që nënkupton udhëheqje jo etike të dëshmitarit.
- 1.6.2 Ndonëse praktika e testimit të dëshmitarit duket se është pranuar nga tribunalet ndërkombëtare, duket se është një praktikë e njohur që prokuroria i njofton palët tjera dhe gjykatën lidhur me qëllimin e saj për ta bërë një gjë të tillë. Për më tepër, fushëveprimi i përgatitjes së dëshmitarit për dëshmi përkufizohet në atë mënyrë që rreziku i paragjykimit të jetë i kufizuar<sup>3</sup>. Prokurori i rastit qartësisht ka dështuar në respektimin e kësaj praktike. Megjithatë, mbrojtja ka qenë e vetëdijshme për këtë testim dhe e ka patur rastin që ta sfidojë besueshmërinë e dëshmitarit gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë.
- 1.6.3 Praktika e takimit me dëshmitarë pasi të jetë ngritur aktakuza dhe pasa se ai të paraqitet në gjykatë nuk rregullohet nga ligji i Kosovës. Prandaj, ajo nuk mund të konsiderohet si shprehimisht e ndaluar. Është mendim i Gjykatës së Apelit se nuk janë paraqitur baza

---

<sup>3</sup> Shih p.sh. Prokurori kundër L dhe të tjerëve, Vendimi mbi Propozimin e Mbrojtjes lidhur me Praktikën e Prokurorisë për ‘Testimin’ e Dëshmitarëve, 10 dhjetor 2004 TNPJ.

lidhur me supozimin se testimi i dëshmitarit në këtë rast në të vërtetë ka rezultuar me paragjykim.

- 1.7 Gjykata e Apelit nuk pajtohet me argumentin e avokatit mbrojtës se nuk janë vërtetuar veprimet individuale dhe specifike të të Akuzuarit. Edhe pse gjykata e shkallës së parë nuk ka elaboruar në arsyetimin e vet lidhur me natyrën e bashkëkryerjes në lidhje me veprimet penale për të cilat është dënua XhK, faktet e vërtetuara nga kjo gjykatë e mbështesin konstatimin se Xh K ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për veprimet e personave të cilët i kanë torturuar viktimat dhe i kanë mbajtur ato në kushte çnjerëzore. Secili veprim individual i ndërmarrë nga persona të veçantë duke përfshirë këtu të Akuzuarin është bërë në prani të kryerësve të tjerë. Secili kryerës ka shfrytëzuar veprimet e kryera nga të tjerët me qëllim që ata e kanë privuar viktimën nga vullneti për të rezistuar. Secili veprim individual i ndërmarrë nga faktori individual i ka shtyrë të tjerët për ta bërë të njëjtën gjë. Prandaj, veprimet e kryera nga i Akuzuari në vendin e ngjarjes kanë përbërë një mbështetje të madhe për të tjerët dhe duhet të konsiderohen si kontribut thelbësor në kryerjen e veprave penale në fjalë. Kjo e përmbush përkufizimin e bashkëkryerjes i cili është dhënë në të dy ligjet të cilat i ka shqyrtuar Gjykata e Apelit gjatë përcaktimit të cilësimit juridik të veprave penale që i janë atribuar të Akuzuarit, përkatësisht neni 23 i KPPK-së dhe neni 31 i KPRK-së:

*“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale.”*

2. Në lidhje me shkeljen e ligjit penal, Gjykata e Apelit i ka trajtuar *ex officio* çështjet në vijim:
- 2.1 Cilësimi i veprave penale që i atribuohen të Akuzuarit si krime lufte kundër personave civilë.
- 2.1.1 Gjykata e shkallës së parë i ka cilësuar gabimisht veprat penale që i atribuohen të akuzuarit të cilat janë paraqitur në Akuzën I si krime lufte kundër popullatës civile e jo si krime lufte kundër personave civilë.
- 2.1.2 Gjykata nuk ka shpjeguar pse grupi i përbërë nga disa viktima duhet të konsiderohet si “popullatë civile” dhe jo vetëm si “persona civile”.

- 2.1.3 Mbrojtja juridike e civilëve në situata të konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar ka filluar me nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të miratuara më 12 gusht 1949.
- 2.1.4 Përshkrimi i veprave që ndalohen është plotësuar nga neni 4 paragrafi 2 i Protokollit Shtesë II.
- 2.1.5 Republika Federative Popullore e Jugosllavisë e ka ratifikuar Konventën e Gjenevës të gushtit të vitit 1949, e cila e ka vënë në zbatim nenin 3 të përbashkët, më 15 shtator 1950.<sup>4</sup> Protokollin Shtesë II i katër Konventave të Gjenevës është ratifikuar më 28 dhjetor 1978 nga shteti nën emrin e tij të ri, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë.<sup>5</sup>
- 2.1.6 Mbrojtja e personave civilë gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në të drejtën vendore e cila ka qenë në fuqi në Jugosllavi në kohën e luftës në Kosovë, e më pastaj në Kosovë deri në shqiptimin e dënimit në këtë lëndë, i është nënshtruar një evoluimi të madh.
- 2.1.7 Fillimisht, neni 142 i KPRSFJ-së, në formulimin e tij të vënë në zbatim më 1 korrik 1977, i ka penalizuar si krime lufte vetëm ato vepra të cilat kanë qenë të drejtuara kundër popullatës civile. Veprat tjera penale të cilat janë drejtuar kundër personave civilë kanë penalizuar si krime të rëndomta.
- 2.1.8 Ndryshimi i nenit 142 të KPRSFJ-së i cili ka hyrë në fuqi më 30 gusht 1990 e ka zgjeruar fushën e veprimit të penalizimit të veprave kundër civilëve. Përveç shumë veprave penale kundër popullatës civile, ai po ashtu ka penalizuar si krim i luftës sulmin kundër personave civilë apo personave të paaftë për të luftuar. Megjithatë, vetëm sulmet që kanë rezultuar me vdekje, lëndime të rënda trupore apo dëmtim të rëndë të shëndetit të njerëzve janë përkufizuar si krime lufte.<sup>6</sup>
- 2.1.9 Si rregull i përgjithshëm i parashikuar nga Rregullorja e 12 dhjetorit 1999,<sup>7</sup> e nxjerrë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara, që kishte fuqi prapavepruese prej 10 qershorit 1999, ligji që kishte hyrë në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989 dhe para 10 qershorit 1999 nuk ishte i zbatueshëm. Sidoqoftë, krimet e

<sup>4</sup> Službeni vjesnik Predizijuma Narodne skupštine FNRJ broj 6/1950. od 15. rujna 1950.

<sup>5</sup> Službeni list SFRJ - Međunarodni ugovori 16/1978. od 18. prosinca 1978.

<sup>6</sup> 13 Službeni List SFRJ 38/90.

<sup>7</sup> 14RREG/UNMIK/1999/24 e 12 dhjetorit 1999.

luftës kundër personave individualë nuk ishin objekt i ndonjë dispozite të mëparshme. Prandaj, në bazë të paragrafit 1.2 të Rregullores, gjykata mund të zbatonte përjashtimisht dispozitat përkatëse që kishin hyrë në fuqi pas 22 marsit 1989, për sa kohë që ato nuk ishin diskriminuese për Kosovën.

- 2.1.10 Sidoqoftë, as neni 142 i ndryshuar i KPRSFJ-së në formulimin e tij të përfshirë më 30 gusht 1990, nuk i quajti vepra penale veprimet që nuk shkaktonin lëndime të rënda trupore apo dëmtime të rënda të shëndetit të viktimave. Duhet theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk bëri asnjë konstatim lidhur me rezultatet e tilla të veprimeve të Xh K.
- 2.1.11 Për më tepër, për shkak të parimit të identitetit subjektiv të aktgjykimit në lidhje me aktakuzën, krimet që iu atribuuan të akuzuarit në aktgjykim nuk mund të përbëheshin nga elementë materialë që nuk ishin të pranishëm në përshkrimin e akuzave të bërë në aktakuzë. Për këto arsye, Gjykata e Apelit nuk mundi t'u atribuonte ndonjë lëndim trupor konkret veprimeve për të cilat u dënua i akuzuari.
- 2.1.12 Dënimi i krimeve të luftës kundër individëve u fut në rendin e brendshëm juridik të Kosovës vetëm pas përfundimit të luftës në Kosovë.
- 2.1.13 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008, njeh një përjashtim material nga parimi i ligjshmërisë, i cili përcakton se askush nuk duhet të dënohet për ndonjë veprim apo lëshim që nuk përbënte vepër penale sipas ligjit në fuqi në kohën kur u krye ai veprim apo lëshim.
- 2.1.14 Përjashtimi nga parimi i ligjshmërisë lejon dënimin e kryerësve për vepra të cilat në kohën kur u kryen përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare. Parimi i ligjshmërisë dhe përjashtimi nga parimi i mos-prapaveprimit të së drejtës materiale penale shprehen në Nenin 33 paragrafi 1 të Kushtetutës:

*“Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.”*

2.1.15 Ky përjashtim nga parimi i ligjshmërisë qëndron në përputhje me Nenin 7 paragrafët 1 dhe 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut:<sup>8</sup>

*“1. Askush nuk do të quhet fajtor për një veprë penale për shkak të ndonjë veprimi ose mosveprimi që nuk përbënte veprë penale sipas së drejtës kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi në kohën e kryerjes. As do të vendoset dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale.*

*2. Ky nen nuk paragjykon gjykimin dhe ndëshkimin e çdo personi për një veprim a mosveprim i cili, në kohën e kryerjes, ishte kriminal sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara.”*

2.1.16 Si pasojë e përjashtimit nga parimi i mos-prapaveprueshmërisë të së drejtës materiale penale, për klasifikimin ligjor të krimeve përkatëse duhet të analizohet jo vetëm KPRSFJ që ishte në fuqi në kohën e kryerjes, por edhe legjislacioni i mëpasëm, respektivisht Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK)<sup>9</sup> dhe KPRK.

2.1.17 Neni 120 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe i KPK-së parashikonte që:

*“Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dënohet me së paku pesë deri në 20 vjet burgim ose me burgim afatgjatë.”*

2.1.18. Me rëndësi thelbësore për rastin në fjalë është se Neni 120 paragrafi 2 i Kodit përcaktoi si vepra përbëjnë krim lufte kundër civilëve vetëm disa nga aktet e përmendura në Nenin 3 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949:

*“Shkelje e rëndë e nenit 3, i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër*

---

<sup>8</sup> Sipas nenit 22 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dispozitat e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

<sup>9</sup> Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) u miratua nga UNMIK-u. Kodi hyri në fuqi më 6 prill 2004. Sipas Ligjit Nr. 03/L-002 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 6 nëntor 2008, Kodi u riemërua si Kodi Penal i Kosovës (KPK) pa ndonjë ndryshim në formulimin e nenit 120. Personat e mbrojtur u përcaktuan jo vetëm si civilë, por edhe si persona të cilët nuk marrin pjesë në luftime.

*personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:*

*1) Dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;*

*2) Kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi degradues;*

*3) Marrja e pengjeve;”*

2.1.19. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, që zëvendësoi KPK-në, përsëriti fjalë për fjalë përkufizimin e krimit të dhënë në Nenin 120 të KPPK-së. Ai parashikoi përkufizimin e personave të mbrojtur, por e zgjeroi katalogun e akteve të ndaluara.

Sipas Nenit 152 të KPRK-së:

*“1. Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) deri në 15 vjet ose me burgim të përjetshëm.*

*2. Shkelje e rëndë e nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:*

*2.1. dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;*

*2.2. kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues;*

*2.3. marrja e pengjeve;*

*2.4. shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme.”*



- 2.1.20. Gjykata e Apelit vlerësoi se veprimet e përshkruara në Akuzën I, Pika 3 – paraburgimi i viktimave në kushte çnjerëzore, dhe në Akuzën I, Pika 4 – viktimat, përkojnë me karakteristikat e krimeve të luftës kundër individëve, të përcaktuara në Nenin 120 paragrafi 2 nën-paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, dhe në të njëjtën kohë në nenin 152 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.2 të KPRK-së.
- 2.1.21. Për të vlerësuar sa duhet përmbajtjen dhe peshën penale të veprimeve që iu atribuuan të akuzuarit, Gjykata e Apelit arriti në përfundimin se:
- mbajtja e viktimave në kushte çnjerëzore arriti shkallën e akteve fyese ndaj dinjitetit të tyre personal dhe përbën trajtim poshtërues dhe degradues (Pika 3 e Akuzës I);
  - torturimi i viktimave përbëri dhunë ndaj jetës dhe njerëzve (Pika 4 e Akuzës I);
  - shkelja e integritetit trupor dhe e shëndetit arriti në akte fyese ndaj dinjitetit personal, në veçanti në trajtim mizor, poshtërues dhe degradues (Pika 5 e Akuzës I).
- 2.1.22. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit e korrigjoi përshkrimin e krimeve që iu atribuuan të Akuzuarit për të treguar në mënyrë adekuate të gjitha elementet e këtyre krimeve.
- 2.1.23. Në lidhje me trajtimin çnjerëzor të viktimave, Gjykata e Apelit hodhi poshtë argumentimin se të gjithë refugjatët nga Kosova po kalonin kushte primitive të jetesës. Kufizimet në qasjen në ujë dhe pijshëm dhe kujdesin higjieno-sanitar, të cilave iu nënshtruan të paraburgosurit, nuk mund të justifikohen me gjendjen e përgjithshme në Kukës. Këto kufizime qartazi mund të shmangeshin dhe për këtë arsye ato duhet të perceptohen si represione.
- 2.1.24. Sipas të dy kodeve në fjalë (KPK dhe KPRK), veprimet e kryera nga Xh K duhej të klasifikoheshin si krime të veçanta në bashkim real, pasi veprimet e tij përfshinin *modus operandi* të ndryshëm.
- 2.1.25. Ndërkohë që krimet në fjalë Gjykata e Apelit i konsideroi si krime lufte, ajo mori parasysh lidhjen midis konfliktit të armatosur në Kosovë dhe situatës në vendet e paraburgimit në Kukës.

- 2.1.25.1. Ekzistenca e konfliktit të armatosur në Kosovë në kohën kritike është një fakt i njohur. Kukësi ndodhet në territorin e Shqipërisë që nuk ishte skenë lufte në atë kohë.
- 2.1.25.2. Gjykata e Apelit arriti në përfundimin se aktet që ndodhën në Kukës ishin të lidhura qartë me konfliktin e armatosur që po zhvillohej në Kosovë. Të gjithë kryerësit ishin anëtarë të një grupi të armatosur që ishte i strukturuar mirë dhe që kontrollonte në mënyrë efektive vendin ku qëndronin ose u arrestuan personat e zhvendosur nga Kosova. Nuk kishte asnjë kontroll nga ndonjë agjenci qeveritare ose ligj-zbatuese të drejtuar nga shteti. Prandaj civilët u privuan nga çdo formë e mbrojtjes ligjore kundër akteve arbitrare dhe fyese të kryera nga ushtarët e UÇK-së. Fajtorët, duke përfshirë Xh K, gëzuan pandëshkueshmëri të përkohshme.
- 2.1.25.3. Gjykata e Apelit zbatoi konceptin e paraqitur nga Tribunali i Hagës në çështjen Delalic se një krim lufte mund të kryhet edhe nëse “nuk ndodhnin konfrontime të mëdha në rajon në kohën dhe vendin” ku dyshohet se janë kryer krimet<sup>1</sup>.
- 2.2. Klasifikimi i veprimeve të përshkruara në Pikat 2 dhe 6 të Akuzës I të Aktakuzës (paraburgimi i kundërligjshëm) si vepër penale e detyrimit, sipas nenit 46 paragrafi 1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK) të 28 qershorit 1977
- 2.2.1** Paraburgimi i paligjshëm i civilëve si individë nuk ndëshkohet si krim lufte kundër personave si individë nga ndonjë statut i zbatueshëm. Prandaj ishte e nevojshme të analizohej mundësia që faktet e përfshira akuza të klasifikoheshin si shkelje tjetër.
- 2.2.2** KPRSFJ nuk përcaktonte ndonjë krim që do të përbëhej nga paraburgimi i paligjshëm i një personi. Një vepër e tillë penale dënohej nga kodet penale të republikave ose krahinave autonome.
- 2.2.3** Në lidhje me krimet e kryera jashtë territorit të Jugosllavisë, Neni 112 i KPRSFJ-së parashikonte si në vijim:

*Kodi penal i republikës ose i krahinës autonome në të cilën po gjykohet një kriminel zbatohet për veprat penale të përcaktuara në kodin e asaj republike*

*ose province autonome në rastet kur këto vepra janë kryer jashtë territorit të RSFJ-së [...]*

- 2.2.4** Paraburgimi i paligjshëm i një personi plotëson karakteristikat e veprës penale të detyrimit, të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të datës 28 qershor 1977 (LPKSAK)<sup>10</sup>:

*Kushdo që me anë të forcës ose një kërcënimi serioz, e detyron një person tjetër të bëjë apo të mos bëjë diçka, ose e bën të vuajë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.*

- 2.2.5** Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 nën-paragrafi 6 të KPRSFJ-së, ndjekja penale e detyrimit është e ndaluar pas kalimit të dy viteve nga kryerja e tij.

### **3. Përshkrimi i gabuar i krimit të posedimit të paligjshëm të armëve**

- 3.1 Gjykata e shkallës së parë e ka gjetur të Akuzuarin fajtor për mbajtje në pronësi, kontroll dhe posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve. Krimi konkret që i atribuohet të akuzuarit përshkruhej në këtë mënyrë:

*[...] se në datën e arrestimit të tij (06.10.2015), në automjetin e tij në Prizren (Kosovë) u gjetën një pistoletë M56, 7.66mm, dhe tre thika palosëse më 06 tetor 2015.*

- 3.1.1 Ky veprim u klasifikua nga gjykata e shkallës së parë si mbajtje në pronësi, kontroll dhe posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 374 paragrafi 1, lidhur me Nenin 120, pika 38, të KPRK-së.
- 3.1.2 Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë pranoi se në të vërtetë përdorimi i armëve nuk u arrit të vërtetohej.
- 3.1.3 Gjykata e Apelit e gjeti të gabuar përshkrimin e krimit të lidhur me posedimin e armëve që iu atribuua të Akuzuarit, për arsyet e mëposhtme:
- 3 thikat palosëse nuk mund të jenë objekt i veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 374 paragrafi 1 të KPRK-së;

---

<sup>10</sup> PS Nr. 011-25/77

- përshkrimi nuk përmban citimin e ligjit të zbatueshëm që u shkel nga i Akuzuari;
  - përshkrimi nuk pasqyron dashjen si thelbësore për fajësinë.
- 3.2 Klasifikimi i posedimit të objekteve që nuk janë armë zjarri si krim i posedimit të paligjshëm të armës
- 3.2.1 Sipas nenit 374 paragrafi 1, veprimi i mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të armëve mund të përbëjë krim vetëm nëse kryhet në kundërshtim me ligjin në fuqi.
- 3.2.2 Gjykata e shkallës së parë i konsideroi të 3 thikat palosëse që u konfiskuan nga automjeti i të Akuzuarit në ditën e arrestimit të tij si armë që bien brenda kuptimit të përcaktimit të nenit 374 paragrafi 1 të KPRK-së.
- 3.2.3 Përkufizimi i përgjithshëm i armës, që jepet në nenin 120 paragrafi 38 të KPRK-së, lejon që një thikë të konsiderohet armë e ftohtë nëse “qëllimi kryesor i saj është të kryhet një sulm fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose pasurisë”. Është e qartë se jo të gjitha thikat përfshihen në këtë përkufizim. Gjykata e shkallës së parë nuk shqyrtoi tiparet e thikave të përmendura.
- 3.2.4 Edhe pa shqyrtimin e mëtutjeshëm të tipareve të thikave në fjalë, posedimi i tyre në një vend tjetër dhe jo në objektet dhe hapësirat sportive nuk përbën shkelje të ligjit të zbatueshëm në Kosovë.
- 3.2.5 Në ligjin e Kosovës ekzistojnë rregulla të rrepta në lidhje me armët e zjarrit. Në të njëjtën kohë nuk ka kufizime për posedimin e thikave të tjera, përveç atyre që rrjedhin nga neni 71 i Ligjit për Sportet<sup>11</sup>, që ndalon mbajtjen dhe përdorimin e çdo arme në mjediset dhe zonat sportive. Ky ndalim nuk është relevant për rrethanat në këtë lëndë.
- 3.2.6 Për këtë arsye, Gjykata e Apelit e korrigjoi përshkrimin e veprës penale të posedimit të paautorizuar të armëve që i atribuohet të Akuzuarit duke eliminuar sendet që nuk mund të jenë objekt i këtij krimi.
- 3.3 Citimi i ligjit të zbatueshëm që u shkel nga i Akuzuari
- 3.3.1 Pasi që përshkrimi i veprës penale për të cilën dënohet fajtori duhet të përmbajë të gjitha elementet ligjore të krimit, të dhëna në përkufizimin e tij, ishte e nevojshme të

---

<sup>11</sup> Law on sport 2003/24

citoheshin dispozitat që janë të zbatueshme për posedimin e armëve dhe që janë shkelur në të vërtetë.

3.3.2 Për këtë arsye Gjykata e Apelit tregoi në dispozitiv se pistoleta M57, kal. 7.62 mm, me numër serik 19Z45Z, dhe krehri Full-Total me 19 fishekë, përbënin një armë të kategorisë B1, siç përcaktohet me Ligjin nr. 05/L-022 për Armët, dhe se i Akuzuari ishte në posedim të kësaj arme pa Leje për Armëmbajtje, të kërkuar nga neni 18.

3.4 Treguesi i *actus reus* të posedimit të armës në dispozitiv

3.4.1 Si rregull i përgjithshëm, përshkrimi i veprës penale që i atribuohet fajtorit në aktgjykimin dënues duhet të pasqyrojë veprimin ose sjelljen që është element përbërës i krimit (*actus reus*).

3.4.2 Treguesi se armët u gjetën në automjetin që i përket të Akuzuarit, i paraqitur në formulimin e përdorur nga gjykata e shkallës së parë, lë hapësirë për dyshime lidhur me dijeninë nga ana e fajtorit se armët ishin të pranishme në makinë. Ky tregues nuk përmbante asnjë *actus reus*.

3.4.3 Pasi që i Akuzuari u vetë-deklarua fajtor për veprën e mbajtjes në pronësi, posedim ose kontroll të paautorizuar ose armëve, përshkrimi i veprës u ndryshua.

III. Dënimi nga Gjykata e Apelit

1. Si pasojë e korigjimit të klasifikimit juridik të krimeve që iu veshën të Akuzuarit, Gjykata e Apelit bëri këtë formulim:

1.1. **Dënimi për krime lufte nga Gjykata e Apelit**

1.1.1. Gjykata e Apelit kishte për detyrë të shqiptonte dënim në përputhje me klasifikimin e ndryshuar të krimeve të dhëna më lart.

1.1.2. Përcaktimi i ligjit të zbatueshëm për dënimin (*lex mitior*)

1.1.2.1. Në periudhën nga kryerja e veprave penale deri në dënim ka ekzistuar parimi i përcaktuar qartë i zbatimit të detyrueshëm të ligjit më të favorshëm material në fuqi në Kosovë.

1.1.2.2. Sipas Nenit 4 të KPRSFJ-së:

*(1) Ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer një veprë penale, zbatohet ndaj personit që ka kryer atë veprë penale.*

*(2) Nëse ligji ka ndryshuar një ose më shumë herë pas kryerjes së veprës penale, zbatohet ligji që është më pak i ashpër në lidhje me kryerësin.*

- 1.1.2.3. I njëjti parim u përsërit në legjislacionin e mëpasëm, pra në Nenin 2 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së dhe Nenin 3 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK-së.
- 1.1.2.4. Ligji nuk përcakton asnjë kriter për të treguar ligjin më të favorshëm. Kolegji zbatoi interpretimin që dikton shqyrtimin e situatës specifike të të akuzuarit. Ai bëri të nevojshëm një simulim të dënimit në përputhje me të dy ligjet përkatëse.
- 1.1.2.5. Sipas të dy kodeve që parashikonin dënimin e krimeve të luftës kundër civilëve individualë, lloji i vetëm i dënimit është ai me burgim.
- 1.1.2.6. Në veçanti, dënimi i paraparë me nenin 120 paragrafi 1 të KPPK-së ishte burgosja me të paktën pesë deri në njëzet vjet ose burgim afatgjatë. Sipas nenit 37 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së dënimi me burgim afatgjatë mund të shqiptohet për veprat penale më të rënda të kryera me dashje, ose në rrethana veçanërisht rënduese, ose duke shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda. Ky dënim mund të zgjasë për një periudhë prej njëzet e një deri në dyzet vjet.
- 1.1.2.7. Dënimet e parashikuara nga neni 152 paragrafi 1 janë me burgim jo më pak se pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm. Sipas Nenit 45 paragrafi 1, burgimi mund të zgjasë deri në 25 vjet. Sipas nenit 44 paragrafi 1, dënimi me burgim të përjetshëm mund të shqiptohet për veprat penale më të rënda të kryera në rrethana veçanërisht rënduese, ose veprat penale që kanë shkaktuar pasoja të rënda.
- 1.1.2.8. Gjykata e Apelit arriti në përfundimin se rrethanat e lëndës nuk e arsyetonin caktimin ndaj të akuzuarit të burgimit afatgjatë ose burgimit të përjetshëm, pasi që krimi që ai ka kryer nuk mund të konsiderohej si vepra më e rëndë penale, as shkaktoi pasoja mjaft të rënda.
- 1.1.2.9. Duke zbatuar rregullin e nenit 33 paragrafi 1 të Kushtetutës së Kosovës, krimet e luftës që i atribuohen Xh K duhet të dënohen edhe pse nuk dënoheshin nga ligji i brendshëm në kohën e kryerjes së tyre dhe në atë kohë nuk parashikohej dënim për ato vepra. Në bazë të nenit 33 paragrafi 2 të Kushtetutës:

*“Asnjë dënim për një veprë penale nuk duhet ta tejkalojë dënimin e parashikuar me ligj në kohën kur është kryer vepra penale.”*

- 1.1.2.10. Gjykata e Apelit është e mendimit se shprehja “dënimi i parashikuar me ligj” i referohet llojit të dënimit dhe jo dënimit të parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.
- 1.1.2.11. Duke zbatuar rregullin e përgjithshëm të përfshirë në Rregulloren e UNMIK-ut të 12 dhjetorit 1999 (*vep. cit.*)<sup>12</sup> të miratuar nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara, ligji që duhet të zbatohet në lidhje me dënimet penale për krimet në fjalë është ligji që ishte në fuqi në Kosovë para datës 22 mars 1989. Sipas paragrafit 1.2 të Rregullores, gjykata mund të zbatojë përjashtimisht dispozitat përkatëse të cilat kanë hyrë në fuqi pas 22 marsit 1989 në qoftë se ato nuk ishin diskriminuese për Kosovën dhe vetëm nëse çështja nuk ishte e mbuluar nga ligji që ishte në fuqi para kësaj date. Megjithatë, çështja e kohëzgjatjes minimale ose maksimale të burgimit tashmë ishte rregulluar në nenin 38 paragrafi 1 të KPRSFJ-së në formulimin e tij të miratuar më 1 korrik 1977. Formulimi fillestar i kësaj dispozite përcaktonte se dënimi me burgim nuk mund të jetë më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 15 vjet. Duhet theksuar se i njëjti ligj parashikonte dënimin me vdekje, i cili u shfuqizua nga paragrafi 1.5 i Rregullores në fjalë të UNMIK-ut.
- 1.1.2.12. Kur vendosi lidhur me dënimet për krimet e luftës, Gjykata e Apelit mori parasysh qëllimet e renditura në nenin 33 të KPRSFJ-së. Prioritet iu kushtua nevojës për të rritur moralin dhe për të forcuar detyrimin për të respektuar ligjin. Gjykata u udhëhoq edhe nga parimi i parandalimit të përgjithshëm duke pasur parasysh se aktgjykimi duhet t’i frenojë njerëzit e tjerë nga kryerja e veprave penale. Gjykata zbatoi detyrimin e saj për të vlerësuar të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, siç kërkohet me nenin 41 të KPRSFJ-së.
- 1.1.2.13. Si faktorë rëndues në lidhje me krimet e luftës në fjalë, Gjykata e Apelit mori parasysh faktin se i Akuzuari nuk ka treguar ndonjë shenjë pendese për keqtrajtimin e të burgosurve. Në të njëjtën kohë, Gjykata mbajti parasysh nivelin e madh të vuajtjeve të cilave viktimat iu nënshtruan.

---

12 14RREG/UNMIK/1999/24 e 12 dhjetorit 1999.

1.1.2.14. Si rrethanë lehtësuese, Gjykata mori parasysh se i Akuzuari tregoi njëfarë ndjenje njerëzore ndaj të burgosurve duke u kthyer batanijet e tyre.

## 1.2. Hedhja poshtë e akuzës së paraburgimit të paligjshëm

1.2.1. Nisur nga klasifikimi i Pikave 2 dhe 6 të Akuzës I si detyrim, sipas nenit 46 paragrafi 1 të LPKSAK-së, dhe në pajtim me nenin 363 paragrafi 1.3 të KPP-së, këto akuza u hodhën poshtë për shkak të kalimit të periudhës së parashkrimit, të përcaktuar në Nenin 95 paragrafi 1 nën-paragrafi 6 të KPRSFJ-së.

## 1.3. Dënimi për posedim të paautorizuar të armës

1.3.1. Lidhur me dënimin për mbajtjen në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, Gjykata e Apelit vendosi duke pasur parasysh rregullat e përgjithshme për llogaritjen e dënimit, të dhëna në nenin 73 të KPRK-së (kodi i ri), peshën e veprave penale nga njëra anë, dhe të ardhurat e kufizuara të të Akuzuarit, si dhe faktin që ai nuk duhet të konsiderohet si person i pasur, nga ana tjetër.

## 1.4. Përlllogaritja e dënimit unik

1.4.1. Ligji nuk e rregullon shprehimisht situatën e dënimeve individuale për krimet e klasifikuara në ligje të ndryshme që përfshijnë rregulla të përgjithshme për llogaritjen e dënimit, që ishin në fuqi në kohë të ndryshme. Prandaj, duhet të ndiqet rregulli i përgjithshëm i zbatueshmërisë së *lex mitior*.

1.4.2. Si KPRSFJ, ashtu edhe KPRK përmbajnë dispozita për dënim unik të krimeve që janë kryer në bashkim real. Dispozitat e KPRSFJ-së duket se janë më të buta për të Akuzuarin:

1.4.2.1. në bazë të nenit 48 paragrafi 3 të KPRSFJ-së, dënimi unik nuk mund të jetë aq i lartë sa totali i të gjitha dënimeve individuale, dhe nuk mund ta kalojë një periudhë prej 15 vjetësh;

1.4.2.2. në bazë të nenit 80 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2. të KPRK-së, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se secili dënim individual, por nuk mund të kalojë një periudhë prej njëzet e pesë (25) vjetësh;

1.4.3. Gjatë shqiptimit të dënimit unik, siç parashihet në nenin 48, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3, të KPRSFJ-së, Gjykata mori parasysh se krimet e veçanta të luftës ishin të lidhur ngushtë me



njëri-tjetrin në kuptimin e kohës dhe vendit, çka arsyetoi më tepër absorbimin e pjesëshëm të dënimeve individuale, se sa akumulimin e tyre.

**1.5. Vendimi për konfiskimin**

1.5.1. Në bazë të nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-së, Gjykata e Apelit kishte për detyrë të konfiskonte pistoletën M57, kal. 7.62 mm, shënuar me numrin serik 19Z45Z, dhe krehrin Full-Total me 19 fishekë.

**1.6. Vendimi për kthimin e sendeve që nuk u konfiskuan**

1.7. Në bazë të nenit 115 paragrafi 1 të KPPRK-së, ishte e detyrueshme t'i ktheheshin të akuzuarit objektet që u konfiskuan prej tij dhe u sekuestruan përkohësisht, por nuk u konfiskuan me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Këto ishin thika e zezë me bllokim të tehut, thika e gjelbër me bllokim të tehut, këllëfi dhe thika e kuqe me shumë funksione.

**1.8. Shpenzimet**

1.8.1. Vendimin e saj lidhur me shpenzimet e procedurës penale Gjykata e Apelit e bazoi në dispozitat ligjore të cekura në dispozitiv. Kostoja e përgjithshme e procedurave është përcaktuar duke marrë parasysh rëndësinë e krimeve që iu atribuuan të akuzuarit dhe numrin e veprimeve hetimore dhe provuese që janë ndërmarrë për të vërtetuar këto akuza.

---

Anna Adamska-Gallant Gjyqtare e EULEX-it

**Anëtarë të kolegjit**

---

Dariusz Sielicki, Gjyqtar i EULEX-it

---

Hava Haliti , Gjyqtare e GJA-së së Kosovës

**Proces-mbajtës**

---

Bekim Ahmeti, këshilltar ligjor i EULEX-it

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

---

<sup>i</sup> TRIBUNALI I HAGËS: Delalic´ dhe të tjerët, IT-96-21- T, Aktgjykim, Dhoma e Shqyrtimit Gjyqësor, 16 nëntor 2008